

MANUAL

PËR

KËSHILLTARËT



Parathënie

I. Roli dhe detyrat e këshillit dhe të këshilltarëve

1. Baza ligjore

Qeverisja vendore zë një vend të rëndësishëm në legjislacionin e vendit tonë. Kjo, me një pjesë të veçantë, është e përfshirë në Kushtetutën e Republikës, të miratuar në vitin 1998.

Në pjesën e gjashtë të saj jepen përcaktime të qarta që: komunat e bashkitë janë njësitë bazë të qeverisjes vendore; vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nepërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore.

Bazuar në nenin 113 të Kushtetutës është këshilli i bashkisë, komunës apo qarkut që rregullon dhe administron në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tij, ushtron të drejtën e pronës, ka të drejtë të mbledhë e të shpenzojë të ardhurat për ushtrimin e funksioneve, vendos taksa, etj. dhe, për zbatimin e tyre, nxjerr urdhëresa, vendime dhe urdhra.

Përcaktimet e mësipërme dhe funksionimin e janë konkretizuar më tej në qeverisjes vendore”. Aty, ligjin organik nr. 8652, datë në mënyrë mjaft të qartë, 31.07.2000 “Për organizimin janë përshkruar parimet

mbi të cilat ndërtohet qeverisja vendore, përkufizimet për njësitë territoriale dhe organet e zgjedhura, mënyra e krijimit të tyre, funksionet dhe kompetencat e organeve të zgjedhura si dhe raportet në mes organit përfaqësues dhe atij ekzekutiv. Në ligjin e mësipërm gjithashtu konkretizohen të drejtat dhe detyrat e çdo këshilltari si i zgjedhur nga komuniteti vendor dhe mënyra se si funksionon këshilli si një tërësi këshilltarësh, si organ kolegjal vendimmarrës.

A është legjislacioni ynë i përputhur me standardet demokratike?

Është mjaft i rëndësishëm fakti që legjislacioni ynë për pushtetin vendor është i orientuar drejt dhe realizon standardet evropiane. Argument për këtë përbën fakti që legjislacioni ynë për qeverisjen vendore mbështetet dhe është në përputhje me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore (Karta), e cila është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë qysh në vitin 1999 dhe, në bazë të Kushtetutës, ka prioritet mbi legjislacionin tjetër të vendit. Të gjitha ballafaqimet dhe analizat e bëra në vitet pas

miratimit të saj tregojnë se përputhshmëria me standardet evropiane vertetohet në vazhdimësi. Në kujtesë të lexuesve evidentojmë se në legjislacionin tonë pasqyrohen përcaktimet bazë të Kartës, nga të cilat, në mënyrë të përmbledhur, përmendim disa si: subsidiariteti, që nënkupton qeverisjen sa më pranë qytetarëve; autoriteti vendimmarrës i organeve të zgjedhura në përputhje me funksionet dhe kompetencat e miratuara me ligj; autonomia në plotësim të misionit qeverisës, duke respektuar ligjin dhe ushtrimi i kontrollit

administrativ nga jashtë vetëm në rastet e parashikuara nga ligji; garantimi me ligj i të drejtës së pronave dhe financave vendore, të domosdoshme për ushtrimin e qeverisjes; e drejta e bashkëpunimit me organe homologe si dhe pjesëmarrja në organizata dhe shoqata, brenda dhe jashtë vendit.

Sa më sipër mund të arrijmë menjëherë në përfundimin se *legjislacioni ynë shërben bindshëm për të ndërtuar një qeverisje vendore demokratike*, pa mohuar nevojën e reflektimit në vazhdimësi të zhvillimeve me dinamikën në rritje. Në këto kushte, niveli i demokracisë vendore lidhet me shkallën e zbatimit në jetën e përditshme nga të gjitha strukturat qeverisëse vendore, por dhe atyre qendrore.

2. Këshilli i bashkisë e komunës si organ përfaqësues i komunitetit vendor

Pozicioni i këshillit të bashkisë dhe komunës është shprehur qartë dhe në mënyrë eksplicite në nenin 109, pika 1 e Kushtetutës, në të cilin shprehimisht thuhet: *“Organet përfaqësuese të njëjësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat...”*

Ky përkufizim kërkon që të interpretohet qartë por edhe të zbatohet drejtë në dinamikën e përditëshme të veprimtarisë në qeverisjen

vendore, që përbën autoritetin e qartë të këshillit për të vepruar në emër të banorëve të komunitetit që ai përfaqëson.

A është i konkretizuar pozicioni i këshillit si organ përfaqësues ?

Ka disa argumente në përgjigje të kësaj pyetje;

- Janë përcaktuar me ligj fushat për të cilat ai vepron në emër të komunitetit. Si të tilla, në nenin 32 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 të tij. Evidentohen fusha e veprimtarisë publike që janë atribuar këshillit në emër të komunitetit që përfaqëson si:

- administrimi, tjetërsimi apo dhënia në përdorim e pronave publike vendore, - miratimi i buxhetit të njësisë vendore, lloji dhe niveli i taksave e tarifave apo për marrjen e kredive, - miratimi i strukturës organizative dhe rregullores bazë të administratës së bashkisë ose të komunës si dhe të njësisë

e institucioneve buxhetore në varësi të saj, - përcaktimi i numrit të personelit, pagat dhe mënyrat e shpërblimit e të kualifikimit të punonjësve dhe personave të zgjedhur, - miratimi i normave, standardeve e kriterëve për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj.

- Këshilli i bashkisë ose komunës është i vetmi organ që, në emër të komunitetit, në plotësim të detyrave të mësipërme, ka autoritetin për të marrë vendime, apo për të nxjerrë urdhëresa e urdhra. Ky autoritet për kompetencat ekskluzive të këshillit, nuk mund t'i delegohet një organi tjetër.

Si qëndron raporti i të drejtës së përfaqësimit të komunitetit me përgjegjësinë para tij, të këshillit në tërësi dhe këshilltarit në veçanti ?

Pa dyshim të qenit antar i këshillit të bashkisë ose komunës përbën një nder dhe vjen si rezultat i përzgjedhjes nga radhët e subjekteve politike, e individëve më të mirë dhe që paraqesin vlera për kontributin që ato kanë dhënë dhe mund të japin për prosperitetin e jetës në komunitet. Për këte, secili nga të zgjedhurit vendor ndjen moralisht kënaqësinë dhe ka se përse të krenohet. Megjithate, ajo që është kryesorja në këte drejtim është “kontrata” që lidh këshilltari në veçanti dhe i gjithë këshilli në tërësi me komunitetin në momentin e zgjedhjes. Në këte rast këshilltarët marrin përsipër të kontribuojnë në emër dhe në dobi të komunitetit në zgjidhjen e problemeve, kryesisht atyre publike, por jo vetëm të tyre, në ushtrim të funksioneve të

ligjshme qeverisëse. Këshilli dhe çdo këshilltarë në këte moment duhet të çlirohet nga këndvështrimi personal dhe jo rrallë i njëanshëm i forcës politike që ai përfaqëson për trajtimin e problemeve por, të aftësohet të jetë përfaqësues i mendimit dhe i kërkesave të komunitetit dhe të kontribuojë për zgjidhje për të cilat është drejtpërdrejtë i interesuar komuniteti. Kjo kërkon që këshilltari mos të mjaftohet të flasë dhe kërkojë zgjidhje për faktin se ka të drejtën të përfaqësojë komunitetin, të flasë në emër të komunitetit, se këte e ka marrë me votën në zgjedhje por, të shkojë më tej duke menduar dhe zgjidhur problemet në përputhje me interesat, kërkesat dhe mënyrën e zgjidhjes që

dëshërojnë qytetarët në tërësi apo sipas rastit grupet e interesit në veçanti. Një raport i tillë do të çojë në një përfaqësim dinjitoz dhe efektiv të këshillit në tërësi dhe të sejcilit nga këshilltarët.

Janë disa veçori që i japin këshilltarit, si përfaqësues i komunitetit, vlera demokratike të cilat e dallojnë nga këshilltarët në sistemin e mëparshëm centralist. Këto veçori duhen vlerësuar dhe përdorur drejtë sepse i japin këshilltarëve mundësinë të jenë kontribues aktiv në rolin qeverisës që kanë marrë përsipër.

3. Disa veçori në ndërtimin e këshillave vendore

- Këshillat vendore formohen si rezultat i një procesi demokratik zgjedhjeje. Ky përbën një faktor shumë të rëndësishëm që këshilltari të ndjehet komod, legjitim dhe me autoritetin për të shërbyer si përfaqësues real i komunitetit. Kjo sepse zgjedhjet për këshillat vendore janë të lira, zhvillohen me votim të fshehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përgjithshme, me garë të hapur midis subjekteve të ndryshme politike apo

kandidatëve të pavarur që marrin pjesë lirëshëm në zgjedhje. Vetë procesi zgjedhor si rregull krijon kushte që në garë të fitojnë ata kandidatë që marrin më shumë vota. Tek ne, në bazë të ligjit aktual, zgjedhjet për anëtarët e këshillit bëhen sipas sistemit proporcional që u jep mundësinë subjekteve zgjedhore të përfaqësohen në këshill me një numër antarësh në raport me përqindjen e votave që kanë fituar në votim për këte organ, pra përfaqësojnë elektoratin që i mbështet,

ndërsa kryetari zgjidhet me sistemin mazhoritar dhe fiton kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave të votuesve përkatës. Sistemi zgjedhor sipas ligjit kërkon që edhe procesi të realizohet në mënyrë korrekte.

- Bazuar në sistemin proporcional në zgjedhjet këshilli i bashkisë apo komunës, ka përbërje pluraliste. Një gjë e tillë bën këte organ mjaft demokratik. Në trajtimin e problemeve në këshill, në kushtet e pluralizmit, bëhet i mundur të zhvillohet debat i hapur në diskutimin dhe miratimin e vendimeve. Në këshill krijohet terreni i duhur për të paraqitur secili këshilltar apo subjekt politik mendimet dhe zgjidhjet e veta në këndvështrimin e politikave përkatëse zhvilluese dhe të opinionëve të marrë nga qytetarët.

- Nga këshilli janë të gjitha kushtet që të sigurohet autonomi e plotë në

vendimmarrje, por kurdoherë në përputhje dhe në kuadër të legjislacionit që rregullon çdo aktivitet në nivel kombëtar. Kjo realizon dhe rrit mjaft forcën vepruese të këshillit por ndërkohë bëhet tregues shumë i rëndësishëm për shkallën e përgjegjshmërisë së këshillit si në rastin e veprimit ashtu edhe të mos veprimit nga ana e tij.

- Këshilli si organ, në juridiksionin e vet, ka autoritet të plotë për të kontrolluar, për probleme me karakter vendor të kompetencës së tij, punën që bëhet nga institucionet e ngarkuara në zbatim të ligjeve dhe vendimeve të këshillit. Ky përbën një tipar shumë të rëndësishëm që këshilli të mund të ndjehet efektiv në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të ligjshme dhe që përbën një rezervë mjaft të madhe në ushtrim të rolit qeverisës të tij.

A përdoren drejtë aktualisht përparësitë e mësipërme ?

Përvoja e deritanishme vërteton se, megjithë progresin e realizuar në shfrytëzimin e mundësive të përcaktuara në legjislacion dhe hapësirat që krijon për veprimtarinë e këshillit, sistemi demokratik i ndertimit të tyre, ende ka mjaft rezerva që në veprimtarinë e përditshme duhet të shfrytëzohen më drejtë.

Disa nga drejtimit në të cilat mund të punohet më tej, pa u kufizuar vetëm në to, mund të jenë:

* Garë e ndershme në zgjedhje për të qenë komod pas zgjedhjeve në besueshmërinë e kërkuar.

* Hyrje në garën zgjedhore nga subjektet politike me programe të qarta dhe konkrete me synim që

ato të jenë kurajoz në aksionet që do të ndërmarrin pas zgjedhjeve. Nuk mund të hyhet në garën zgjedhore me parulla të përgjithshme por duhen angazhime të programuara dhe bindëse.

* Njohje e legjislacionit nga këshilltarët në fushën e funksioneve, kompetencave dhe mënyrën e zgjidhjes së probleme për një vendimarrje sa më të dobishme në kushtet e veçanta të njësisë vendore përkatëse. Premtimet elektorale dhe zbatimi i tyre bëhet vetëm mbi bazen e kompetencave dhe normave proceduriale që parashikohen në legjislacion.

* Më shumë iniciativë dhe vetveprim, larg pritmërisë, shablloneve dhe zgjidhjeve nga lartë. Të shfrytëzohet në mënyrë racionale autonomia vendore. Qeverisja të matet me rezultate

dhe në ballafaqim me premtimet.

* Kontroll sistematik dhe në vazhdimësi me të gjitha mënyrat e ligjshme të

kompetencës së këshillit mbi të gjitha strukturat administrative dhe institucionet e varësisë për të kaluar nga vendimi tek zbatimi..

4. Këshilli – organ kolegjal. Ndertimi dhe funksionimi

Këshilli i bashkisë apo komunës përbëhet nga këshilltarët që rezultojnë se kanë fituar në zgjedhjet për këte organ, sipas shpalljes nga komisioni i zgjedhjeve të qeverisjes vendore (KZQV).

Në mbledhjen e parë të konstituimit (themelimit), çdo këshilltarë merr mandatin, me vendim të këshillit, pas vertetimit nga komisioni i mandateve dhe, pasi këshilltarët bëjnë betimin. (modeli 1 bashkëlidhur).

Veprimtaria e këshillit të bashkisë ose komunës realizohet në bazë të “Statutit të Bashkisë ose Komunës” dhe “Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit” të cilat miratohen nga këshilli.

- Këshilli i bashkisë dhe komunës, në mënyrë kolegjiale nepërmjet mbledhjeve, ushtron funksionet e tij qysh nga krijimi i tij. Mbledhja është momenti dhe vendi ku ushtrohet roli i përfaqësimit të komunitetit. Jashtë mbledhjeve antarët e këshillit, madje edhe kryetari, zëvendëskryetari si dhe sekretari i këshillit informohen, ndihmojnë dhe ndjekin ecurinë e zbatimit të

vendimeve të marra por individualisht nuk kanë mundësi të ndërmarrin nisma apo të ndërhyjnë drejtpërdrejtë në ndyshimin e vendimit të marrë nga këshilli.

Ç'farë duhet mbajtur parasysh për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit ?

a. Mbledhja e këshillit, si ajo e radhës ashtu edhe mbledhja jashtë radhës thirret nga kryetari i këshillit dhe, në mungesë të tij, nga zevendëskryetari i këshillit. Njoftimi **(model 2 bashkëlidhur)** duhet të përmbajë datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës i cili ishte parashikuar më parë nga vetë këshilli apo që kërkohet si më sipër për mbledhjet jashtë radhe.

b. Mbledhja fillon me miratimin nga këshilli i rendit të ditës. Mbledhja zhvillohet dhe quhet e vlefshme kur në te merr pjesë shumica e të gjithë

anëtarëve të këshillit

c. Mbledhjet e këshillit fiksohen në procesverbalin e mbledhjes i cili mbahet sipas rregullave që përcaktohen nga vetë këshilli në rregulloren e funksionimit të këshillit. Si rregull procesverbali mbahet nga sekretaria e miratuar nga këshilli (në te mund të jenë punonjës të administratës). Procesverbali në fund vertetohet nga sekretari i këshillit dhe firmoset nga kryetari i këshillit (drejtuesi i mbledhjes së këshillit). Procesverbali është i hapur për çdo këshilltarë i cili mund të shprehet për saktësinë e mbajtjes së tij.

ç. Kur këshilli nuk mbledhet gjatë tre muajve duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Në këte rast fillojnë procedurat për zhvillimin e zgjedhjeve të reja për organin e shpërndarë. Për këte sekretari i këshillit, brenda 10 ditëve njofton prefektin i cili menjëherë i drejtohet Këshillit të Ministrave për t'i propozuar Presidentit të Republikës caktimin e datës së zgjedhjeve.

e. Sipas rendit të ditës të miratuar në fillim të mbledhjes, këshilli i bashkisë ose komunës diskutimin e problemeve e bën mbi bazën e materialeve që paraqiten në këshill nga ekzekutivi i bashkisë ose komunës dhe më rrallë nga institucione të varësisë drejtpërdrejtë apo ato të përgatitura nga këshilli me grupe pune, komisione etj. Në rast të diskutimit të një problemi të kërkuar nga prefekti, në këshill paraqitet materiali i dërguar nga ana e tij. Si rregull një pikë e rendit të

ditës diskutohet mbi bazën e raportit dhe projektvendimit përkatës. Projektakti duhet të jetë i shoqëruar me relacion. Para se të zhvillohet diskutimi nga këshilltarët paraqiten komentet nga komisioni përkatës i këshillit. Pas diskutimit miratohet vendimi duke tratur me kujdes si projektvendimin ashtu edhe propozimet që bëhen për ndryshime të veçanta.

ë. Këshilli i bashkisë ose komunës, pas çdo problemi që diskuton duhet të nxjerrë aktin (vendim, urdhëresë apourdhër) përkatës që miratohen me votim të hapur ose të fshehtë, sipas mënyrës që ai vetë përcakton. Për aktet me karakter individual votimi bëhet kurdoherë i fshehtë. Si rregull vendimet e këshillit merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Për probleme të rëndësishme vendimet merren me shumicë të cilësuar.

f. Aktet e këshillit firmosen nga kryetari i këshillit të bashkisë ose komunës. Ato shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjektit apo subjekteve përkatëse.

g. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Në këto mbledhje lejohet të marrë pjesë çdo qytetar, sipas rregullores së miratuar nga këshilli. Për këte qellim njoftimet për mbledhjen e këshillit bëhen publike. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve, mund të vendos për raste kur mbledhja do të bëhet e mbyllur.

gj. Në mbledhjet e këshillit si rregull ftohen të marrin pjesë sipas problemit

që diskutohet aktorë të interesit. Në radhë të parë këtu përfshihen kryetari apo zevendëskryetari i bashkisë ose komunës, drejtuesit e drejtorive apo zyrave të administratës së bashkisë, drejtues ose përfaqësues nga institucionet e interesuar dhe sipas nevojës edhe specialist që mund të kontribuojnë në mbarëvajtjen e mbledhjes. Të ftuarit si rregull përcaktohen nga kryetari i këshillit me propozim të sekretarit të këshillit.

h. Për mbarëvajtjen e mbledhjeve të këshillit është jo pak e rëndësishme edhe respektimi i disa rregullave bazë të organizimit të sallës. Ajo duhet të plotësojë disa kushte optimale të domosdoshme. Tavolina për drejtimin e mbledhjes në të cilën rri drejtuesi i mbledhjes (kryetari i këshillit). Në një vend qendror duhet të jetë vendi për kryetarin e bashkisë ose komunës. Përcaktohet vendi i sekretarisë ku do të mbahen procesverbali. Parashikohet

vendi i sekretarit të këshillit që mund të jetë afër sekretarisë së mbledhjes. Në sallë duhet të ketë në numër të plotë vendet për të gjithë anëtarët e këshillit të bashkisë ose komunës. Anëtarët e këshillit duhet të sistemohen në vende fikse sipas përbërjes së grupimeve politike që përfaqësojnë. Bëhet një

radhitje e barazpeshuar, pozitë opozitë, në këshill. Çdo anëtarë duhet ta ndjej vehten të vlerësuar në mbledhje të këshillit. Në sallë, si rregull, pas vendeve të anëtarëve të këshillit duhet të ketë vende për të ftuarit si dhe vende për publikun.

Në cilët drejtime mban përgjegjësi këshilli për punën e tij ?

Këshilli si organ kolegjal mban përgjegjësi e cila evidentohet në drejtimet si më poshtë:

*** Përgjegjësi para ligjit.** Këshilli në çdo rast duhet që veprimtarinë e tij ta karakterizojë respektimi i ligjit. Kjo nuk përjashton mundësinë që të ndër marrin nisma me interes publik vendor për çeshtje që nuk u ndalohen me ligj ose që nuk i janë dhënë me ligj një organi tjetër shtetëror. Në rast shkelje të ligjit vendimet shfuqizohen me vendim gjykate duke korigjuar

të gjitha pasojat që mund të ketë sjellë zbatimi i vendimit.

*** Përgjegjësi para komunitetit.** Kjo reflektohet në ballafaqim me plotësimin e misionit qeverisës si përfaqësues i komunintetit. Komuniteti pret nga këshilli plotësimin e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave për mirëadministrimin e jetës publike me karakter vendor, bazuar në angazhimet e marra në rastin e zgjedhjeve

vendore. Ballanca në këte drejtim bëhet si rregull në fund të mandatit, ndonëse

analiza dhe ballafaqime me komunitetin kërkohet të bëhen në mënyrë më sistematike.

A mund të shpërndahet këshill i bashkisë ose komunës para kohe ?

Këshilli bashkisë ose komunës mund të shpërndahet para përfundimit të mandatit me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 115 i Kushtetutës dhe neni 38 i ligjit 8652 datë 31.7.2000).

Rastet e shpërndarjes së parakohshme të këshillit mund të jenë kur:

- Nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tre mujore;

- Nuk arrinë të marrë vendim për miratimin e buxhetit brenda tre muajve nga data e caktuar me ligj;

- Kryen shkelje të rënda të Kushtetutës dhe ligjeve.

Këshilli i bashkisë ose komunës në rastin e shpërndarjes parakohe, mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese për vendimin e Këshillit të Ministrave, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Ankimi shoqërohet me pezullimin e vendimit të Këshillit të Ministrave. Në rast të lenies në fuqi nga Gjykata Kushtetuese të vendimit të Këshillit të Ministrave, Presidenti i Republikës shpall datën e zgjedhjeve të reja të pjesëshme në njësinë vendore përkatëse sipas përcaktimit dhe procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

5. Roli, të drejtat dhe detyrat e këshilltarit

Krahas faktit se këshilli vepron si organ kolegjal, këshilltari si individ ka një rol të drejtpërdrejtë në ecurinë e punëve në qeverisjen vendore.

Ai gjatë të gjithë kohës që gëzon mandatin kërkohet të jetë aktiv, i angazhuar në ushtrimin e të gjithë funksioneve dhe kompetencave që i janë atribuar këshillit si organ kolegjal.

Puna e këshilltarit lidhet me kontributin e tij:

- i. në mbledhjet e këshillit,
- ii. në përfshirjen e tij sa më mirë në veprimtarinë e komisionit ku bën pjesë si dhe,

iii. në një proces të vazhdueshëm të njohjes së gjendjes dhe në ndjekje të zbatimit të vendimeve të këshillit.

Nga roli që luajnë veças të gjithë anëtarët e këshillit përcaktohet së fundi edhe roli i këshillit në tërësi. Kjo kërkon të pasqyrohet si në veprimtarinë e organizuar në mbledhjet e këshillit ashtu edhe në proces të punës në ndjekje të zbatimit të detyrave.

Si mund të luaj rolin e vet antari i këshillit të bashkisë, komunës ?

Antari i këshillit rolin e tij mund ta luaj kryesisht nepërmjet njohjes dhe përdorimit korrekt të të drejtave dhe plotësimit të

detyrave përkatëse.

* Këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë nga administrata e bashkisë ose komunës përkatëse, çdo lloj dokumentacioni për njohje të problemeve të juridiksionit të saj. Kjo e drejtë realizohet duke respektuar përcaktimet që duhet të shprehen në rregulloren e funksionimit të administratës e cila miratohet nga këshilli.

* Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli dhe me financimin sipas rregullave të legjislacionit për këto raste. Kualifikimi përbën domosdoshmëri me qellim që këshilltarët të rrisin aftësitë e tyre, në ushtrim të misionit të vet pasi veprimtaria e këshillit shtrihet në fusha shumë të larmishme dhe që në përgjithësi janë të panjohura

për këshilltarët për vetë natyrën e punës së origjinës dhe profesioni të tyre.

Këshilltari ka të drejtë të shpërblehet për punën që kryen. Masa e shpërblimit, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, vendoset nga këshilli i bashkisë ose komunës.

Ndër detyrat e këshilltarit përmendim:

* Të bëjë betimin sipas formulës **(modeli 1 bashkëlidhur)**. Këshilltari që nuk pranon të bëjë betimin quhet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati. Bërja e betimit në dukje paraqitet si një akt formal por përbën thelbin e angazhimit të këshilltarit në misionin e tij dhe respektimin rigoroz të kushtetutës dhe ligjit, përbën zyrtarizimin e kontratës që ai lidh me qytetarët e komunitetit përkatës.

* Të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e këshillit. Aty

këshilltari ka vendin ku nga njera anë shpreh mendimet si përfaqësues i komunitetit në tërësi por edhe si përfaqësues i subjektit politik përkatës por nga ana tjetër kontribuon me votën e tij për një vendimmarrje sa më shumë në dobi të komunitetit.

* Të bëjë pjesë në komisionet e këshillit të bashkisë ose komunës sipas ndarjes që bëhet me vendim të këshillit. Këshilltari mund të

marrë pjesë edhe në aktivitetet që zhvillojnë komisionet e tjera të këshillit.

* Këshilltari ka për detyrë të mbajë kontakte të gjalla e të vazhdueshme me komunitetin. Ai merr mendime dhe sugjerime nga banorët në mënyrë të organizuar ose edhe në grupe të veçanta interesi dhe i paraqet me korrektësi në takimet komisionit apo në mbledhjen këshillit.

A ka papajtueshmëri funksioni i këshilltarit ?

Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me funksionin e kryetarit e zëvendëskryetarit të bashkisë e komunës, sekretarit të këshillit të bashkisë, komunës, të nëpunësit të administratës së bashkisë komunës dhe të deputetit. Kjo do të thotë që në

se një këshilltar angazhohet me një nga funksionet e mësipërme menjëherë atij, me vendim këshilli, duhet t'i hiqet mandati i këshilltarit, ose e kundërta kur një person merr mandatin e këshilltarit ai duhet të heq dorë nga funksionet e mësipërme.

***Kujdes z. Këshilltar,
mund të të hiqet parakohe
mandati!***

Mandati mund t'i hiqet këshilltarit me vendim këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve për shkaqe të përligjura : - kur ndryshon vendbanimin, - kur jep dorëheqjen, - kur humbet zotësinë për të

vepruar, - kur vdes, - kur nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për 6 muaj, - kur dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë të gjykatës si dhe - kur shpërndahet këshilli nga organi kompetentë.

Këshilli përveç mbledhjeve plenare, funksionon edhe nëpërmjet komisioneve të tij.

6. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve të këshillit të bashkisë ose komunës

Theksojmë që komisionet mund të jenë: a. të përhershme b. të përkohshme për çështje të veçanta.

Komisionet mund të jenë me karakter të përhershëm apo të përkohshëm. Krijimi i tyre bëhet me vendim të këshillit. Numri dhe lloji i komisioneve përcaktohet me vendim të

këshillit dhe përfshihen në rregulloren këshillit. Ligji organik nr.8652, datë 31.07.2000, detyron krijimin e dy komisioneve, përkatësisht të komisionit të mandateve dhe të komisionit të financave që do të funksionojnë përgjatë gjithë mandatit elektoral, ndërsa komisionet e tjera si dhe numri, emërtimi dhe kohëzgjatja e tyre janë kompetencë e vendimmarrjes së vetë këshillit.

Kryetari dhe zëvendës-kryetari i këshillit nuk

përfshihen në komisione. Ndërkohë komisionet nga anëtarët e përfshirë në to zgjedhin drejtuesit përkatës.

Numri dhe anëtarët e komisioneve zgjidhen nga anëtarët e këshillit me votim të hapur, me propozim të kryetarit të këshillit, pas konsultimeve paraprake me kryetarët e grupeve (partiake) pjesëmarrëse në këshill dhe në përputhje me karakterin dhe veprimtarinë e komisioneve.

Çfarë mund të trajtojë komisioni?

- Ato diskutojnë raporte, projekte e relacione të paraqitura nga ekzekutivi por edhe nga ndërmarrjet dhe institucionet në vartësi të bashkisë.

- Komisionet mund të përgatisin edhe vetë projektvendime, rregullore dhe urdhëresa të shoqëruara me relacionin përkatës

- Komisionet e përhershme të këshillit gjithashtu studjojnë në proces efektivitetin e akteve të nxjerra nga këshilli dhe në përputhje me to nxjerr edhe konkluzionet përkatëse, të cilat paraqiten në këshill në kohën e shqyrtimit të problemeve ose në mënyrë të veçantë

Si funksionon komisioni?

Komisionet e përhershme mbledhen sipas një programi të miratuar nga ana e tij, nga kryetari ose zëvendësi i tij. Komisioni mund të mbledhet edhe me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të komisionit ose me porosi të kryetarit të këshillit. Mbledhjet e komisioneve janë të vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të përbërjes së tyre. Në mbledhjet e komisionit mund të thirren për të dhënë mendime dhe edhe qytetarë jo anëtarë të këshillit, aktorë të intersit, punonjës të administratës, të institucioneve të interesuara etj. Të ftuarit nuk kanë të drejtë vote

Komisionet e përhershme mund të organizojnë edhe

mbledhje të përbashkëta me komisionet e tjera. Në këto raste komisioni drejtohet nga njëri prej drejtuesve sipas mirëkuptimit të vendosur. Në mbledhjet e përbashkëta komisioni mund të marrë vendim të përbashkët ose edhe veç.

Për çdo projekt apo akt të veçantë që shqyrton komisioni, përgatitet një raport i posaçëm i cili i paraqitet këshillit në kohën e shqyrtimit të tij nga kryetari i komisionit ose nga një antar tjetër i autorizuar prej tij. Në raport pasqyrohen të gjitha opinionet e shfaqura për problemin në fjalë. Akti pas shqyrtimit në komision votohet me votim të hapur.

7. Kryetari i këshillit të bashkisë ose komunës

Këshilli i bashkisë ose komunës drejtohet nga kryetari i këshillit i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit.

Zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit bëhet me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

- Detyrat që kryen kryetari i këshillit janë të kufizuara pa pasur kompetenca të mirëfillta.,

bazuar të nenin 36 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000., .

Zevendëskryetari vepron në kryerje të detyrave të mësipërme kur mungon kryetari, dhe është e qartë që në këshill nuk ka kryesi si organ.

8. Sekretari i këshillit të bashkisë ose komunës

Sekretari i këshillit të bashkisë ose komunës ka një rol mjaft të rëndësishëm për mbarëvajtjen e punëve të këshillit, si për zhvillimin e rregullt të mbledhjeve plenare apo të punës në komisione, ashtu edhe në marrëdhëniet e këshillit me administratën dhe me komunitetin.

Si emërohet sekretari i këshillit ?

Sekretari i këshillit emërohet me vendim të këshillit të bashkisë ose komunës, me propozimin e kryetarit të këshillit. Që të quhet i miratuar (emëruar nga këshilli) vendimi duhet të merret me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit. Për shkarkimin e sekretarit mund të sherbejë edhe propozimi i 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

A duhet riemruar sekretari nga këshilli i ri i dalë pas zgjedhjeve të reja ?

Sekretari nuk ka mandat dhe bashkë me këte nuk ka afat kohor në ushtrim të funksionit. Funksioni i tij është thjesht administrativ. Vazhdimi ose jo i punës nga një sekretar i emëruar nga këshilli i mëparshëm, është në varësi të vlerësimit që i bën këshilli punës së sekretarit. Këshilli në çdo kohë mund të shqyrtojë dhe të diskutojë shkarkimin ose emërimin e sekretarit të këshillit.

Cilat janë detyrat e sekretarit të këshillit të bashkisë ose komunës ?

Sekretari i këshillit komunal ose bashkiak përgjigjet për:

- mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit (**modelet në aneks**);

- ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve të këshillit sipas rendit të ditës;
- njoftimin për zhvillimin e mbledhjes së këshillit;
- shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga këshilli i bashkisë ose komunës;
- përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
- mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit;
- çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

9. Kompetencat dhe detyrat konkrete të këshillit të bashkisë ose komunës

Këshilli i bashkisë ose komunës ushtron kompetenca dhe kryen detyra:

- a. sipas përcaktimit me ligj,
 - b. në rast marrëveshjes në mes këshillit dhe një institucioni tjetër kompetent në bazë të ligjit.
- a.** Kompetencat dhe detyrat e përcaktuara me ligj përbëjnë detyrim ligjor dhe duhen plotësuar nga organi i qeverisjes vendore. Zbatimi nga ana e këshillit i kompetencave dhe detyrave bëhet duke respektuar normat që përcakton ligji, të cilat ai i zberthen në kushtet konkrete të bashkisë ose komunës përkatëse (neni 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”)

b. Kompetenca dhe detyra të këshillit në rastet kur ai angazhohet në marrëveshje dy ose më shumë palëshe. Marrëveshje të tilla mund të bëhen në zbatim të dispozitave ligjore:

- në rastin e krijimit të një subjekti të përbashkët me njësi të tjera vendore, p.sh për përpunimin e përbashkët të mbeturinave,
- në rastin kur ai është bashkëpronar me organe të

tjera, p.sh në rastin e bashkëpronësisë në ndërmarrjen e ujësjellësave,

- në rastin e delegimit tek ai i një kompetence nga një organ tjetër i qeverisjes vendore ose i një organi të pushtetit qendror, p.sh në fushën e ndertimeve dhe urbanistikës
- në rastin kur ai i delegon kompetenca një organi tjetër, p.sh këshillit të qarkut për inspektimin e ndertimeve,
- në raste të tjera të pranuar me ligj.

Këshilli i bashkisë ose komunës është i pavarur në plotësimin e funksioneve të veta të ligjshme qeverisëse.

10. Raportet e këshillit të bashkisë ose komunës me organe dhe struktura të tjera

Megjithatë kjo nuk duhet dhe nuk mund të kuptohet se ai vepron i veçuar dhe i shkëputur nga organe dhe struktura të tjera qendrore apo vendore, publike apo

private që veprojnë brenda juridiksionit, ashtu edhe atyre jashtë bashkisë apo komunës përkatëse. Me këto organe apo struktura, këshilli i bashkisë apo komunës vepron në

respektim të mundësive që ato kanë dhe ofrojnë në kushtet e ushtrimit të detyrave të tyre të ligjshme. Është detyrë e këshillit që të bashkëpunojë me këto organe dhe struktura, për

t'i venë ato sa më mirë në shërbim të komunitetit vendor për fusha dhe përfitime me interes reciprok.

a. Cilat janë disa nga raportet kryesore të këshillit me kryetarin e bashkisë ose komunës dhe administratën përkatëse.

Në tërësinë e tyre këto raporte janë institucionale dhe korrekte duke pasur në bazë të tyre plotësimin e kompetencave dhe detyra që kanë me ligj, statutin e bashkisë dhe rregulloret e funksionimit, atë të këshillit nga njëra anë ashtu edhe rregulloren e administratës nga ana tjetër.

* Kryetari i bashkisë ose komunës verteton mandatin e tij nga gjykata në juridiksion të së cilës është bashkia apo komuna përkatëse dhe, më pas në këshill shpallet vlefshmëria e këtij mandati dhe kryetari bën betimin. Ky moment përbën një akt solemn pasi këshilli është

organi përfaqësues i komunitetit por kjo nuk përbën dhe nuk duhet kuptuar në asnjë rast si raport inferioriteti i kryetarit ndaj këshillit. Edhe kryetari është organ i pavarur i qeverisjes vendore i zgjedhur drejtpërdrejtë nga zgjedhësit. Marrëdhëniet e tyre rregullohen në bazë të ligjit dhe, sejcili nga këto dy organe vepron në përputhje me rregullimet ligjore, në ushtrim të funksioneve, kompetencave dhe detyrave që i ngarkon ligji sejcilit prej tyre.

* Këshilli është përgjegjës

për marrjen e vendimeve, nxjerrjen e urdhëresave dhe urdhërave për probleme të kompetencës së tij të cilat u trajtuan më lartë dhe që nuk i delegohen kryetarit të bashkisë ose komunës. Në këte drejtim kryetari është i detyruar të zbatojë vendimet e këshillit. Megjithate, në bazë të nenit 44, pika “h” e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, është e drejta e kryetarit që, kur vëren se një akt, sipas tij, cënon interesat e bashkësisë, mund t’ia kthejë ate këshillit, jo më shumë se një herë, për rishqyrtim. Në këte rast këshilli ka për detyrë t’a rishqyrtojë edhe një herë aktin, vendimi i të cilit duhet zbatuar nga kryetari, qoftë edhe në se ai nuk ka reflektuar ndaj vrejtimeve të bëra. Në se lind konflikt, kryetari i bashkisë mund t’i drejtohet gjykatës për shqyrtim dhe për të vendosur përfundimisht.

* Këshilli kërkon nga kryetari përgatitjen e

materialeve të mbledhjeve të këshillit të bashkisë ose komunës me përjashtim të atyre që janë kompetencë e vetë këshillit si: zgjedhja e drejtuesve të këshillit, sekretarit të këshillit, përfaqësuesve në qark, etj. Kryetari e ka detyrë të ligjshme një gjë të tillë dhe duhet të veprojë në bazë të njoftimeve të rregullta për këto mbledhje e të çeshtjeve që do të shqyrtohen, të dokumentuara nepërmjet sekretarit, me firmë të kryetarit të këshillit.

* Këshilli kërkon nga kryetari dhe administrata e bashkisë ose komunës raporte për plotësimin e funksioneve dhe kompetencave qeverisëse për punën e bërë në zbatim të vendimeve të këshillit. Në mënyrë më të veçantë kryetari raporton në këshill të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë që e kërkon këshilli, për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë ose komunës.

* Këshilli nuk mund të marrë përsipër ushtrimin e

kompetencave që i janë dhënë kryetarit. Në këtë kuptim bëhet mëse i qartë raporti që siguron këshilli me kryetarin e bashkisë ose komunës. Kryetari është organi ekzekutiv që ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë ose komunës, me përjashtim të atyre që janë kompetencë e vetë këshillit përkatës. Kryetari ushtron të drejtat dhe detyrat që i janë ngarkuar bashkisë ose komunës si person juridik.

* Administrata e bashkisë ose komunës funksionon si strukturë, numër punonjësish dhe kryen detyrat që i caktohen asaj në bazë të ligjit, nepërmjet rregullores që miraton këshilli i bashkisë ose komunës. Për funksionimin dhe kryerjen e detyrave, administrata është në varësi të kryetarit dhe drejtohet nga kryetari. Ndërkohë këshilli ka të drejtë të kontrollojë se si kryhen detyrat nga ana e administratës dhe për këtë, përveç kontrolleve në veprimtarinë e përditshme, mund të kërkojë raportime për

punën që bën administrata sa herë e gjykon të nevojshme. Në këto kushte këshilli mund t'i propozojë organit të emërtesës qëndrime në vlerësim të punës së bërë nga punonjës të vëçantë apo njësi të caktuara të strukturës organizative të administratës.

Në praktikë gjenden, ndonëse rrallë, raste të ndertimit të raporteve jo të shëndosha mbase edhe konfliktuale në mes këshillit dhe kryetarit të bashkisë. Ato më së shumti shfaqen në raste të diversitetit politik të dy organeve por jo gjithmonë kështu. Në këto raste ekuilibrimi i marrëdhënieve duhet të bëhet me trajtimin e problemeve sipas kompetencave të përcaktuara nga ligji, mbasi në të kundërtën dëmtohet qeverisja e mirë dhe e pëson komuniteti.

b. Raportet e këshillit të bashkisë ose komunës me institucionet e varësisë

Në raport me institucionet e varësisë nga ana e këshillit respektohen të gjitha normat e përcaktuara nga legjislacioni që përcakton mënyrën e funksionimit të ndermarrjeve apo institucioneve shtetërore sipas tipit të miratuar nga vetë këshilli. Kjo do të thotë që nëse këshilli ka krijuar një ndërmarrje për pastrimin, e cila funksionon si shoqëri

tregtare, atëherë do të zbatohen rregullat e miratuara posaçërisht me ligjin përkatës. Nëse është pranuar krijimi i një subjekti të kompetencave të përbashkëta me një njësi tjetër vendore, atëherë do të vepohet me thirrjen në raport qoftë edhe nga secili por me vendimmarrjen e përbashkët të dy njësisve vendore në përputhje me aktin e themelimit.

c. Raportet e këshillit me prefektin

Raportet e këshillit të bashkisë ose komunës me prefektin rregullohen në bazë të ligjit nr.8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe më konkretisht në përputhje me ligjin nr. 8927, date

25.7.2002 “Për prefektin”. Është në interes reciprok vendosja e raporteve të partneritetit të këshillit me prefektin si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark.

Në raportet në mes këshillit të bashkisë ose komunës me

prefektin nuk ka asnjë marrëdhënie varësie. Ligji i rregullon ato në mënyrë të atillë që sejcili të kryej misionin përkatës.

Si veprohet në punën me aktet e këshillit ?

Këshilli, sipas kreut III të ligjit “Për prefektin”, ka detyrimin që t’i dërgojë prefektit brenda 7 ditëve pas shpalljes, aktet me karakter normativ që miraton. Prefekti ka detyrën që të verifikojë ligjëshmërinë e aktit dhe reagon me përgjigje brenda 10 ditëve. Nëse ka mendime për papajtueshmëri të aktit me ligjin, prefektit i lind e drejta e kthimit të argumentuar pranë këshillit për rishqyrtim të aktit vetëm një herë. Këshilli në këte rast, e diskuton edhe një herë aktin, duke relatuar vrejttet e bëra nga ana e prefektit. Këshilli merr vendimin përfundimtar për aktin, të cilin, të riformuluar pas rishqyrtimit,

ia dërgon prefektit. Proçesi i verifikimit nga prefekti nuk mund të pengojë zbatimin e aktit pasi ai nuk ka autoritetin të pengojë zbatimin e aktit. Nga ana e vet, këshilli mund të pezullojë zbatimin e aktit deri në shqyrtimin e vrejttjeve të prefektit. Nëse prefekti nuk pajtohet në lidhje me ligjëshmërinë e aktit pas rishqyrtimit nga këshilli, ai ka të drejten t’a çojë në gjykatë e cila e shqyrton dhe vendos përfundimisht. Prefekti mund të dergojë në gjykatë një akt të këshillit edhe pa e kthyer fare në këshill, kur ai ka bindjen se kthimi nuk do të shërbejë për përmirësimin e aktit.

Prefekti ka gjithashtu të drejtën të njihet dhe të verifikojë në çdo kohë, në bashki ose komunë edhe vendimet e tjera të marra nga këshilli, sidomos në raste të ankesave tek ai nga banorë apo organizata e institucione të prekura nga vendimet e këshillit. Në këto raste, kur

lind nevoja, për papajtueshmëri me ligjin, prefekti, në kohën e konstatimit, kërkon njëllor rishikimin e aktit përkatës nga këshilli, i cili e shqyrton dhe vendos përfundimisht. Prefekti edhe në këte rast mund ta dërgojë çeshtjen në gjykatë, si edhe më lartë për aktet normative.

Po në veprimtarinë tjetër, atë të zakonshme ?

Partneriteti i këshillit me prefektin nënkupton që këshilli të njoftojë në vazhdimësi prefektin për

aktivitetet që do të zhvillojë ku përfshihen edhe mbledhjet dhe të kërkojë pjesëmarrjen e tij apo të përfaqësuesit të ngarkuar nga ai. Ndërkohë edhe prefekti do të duhet të kërkojë pjesëmarrjen apo të informojë këshillin për aktivitetet e prefekturës, sidomos ato që zhvillon në juridiksionin e këshillit e, për më tepër ato që lidhen me ushtrimin e kompetencave nga ana e këshillit. Këshilli për probleme që i lindin në marrëdhënie me organet dhe institucionet qendrore mund t'i drejtohet prefektit. Në këto raste prefekti duhet ti trajtojë me vemendje dhe të ndjek ecurinë e mëtejshme të tyre nga institucionet përkatëse.

d. Raportet e këshillit të bashkisë ose komunës me biznesin

Tek biznesi këshilli i bashkisë ose komunës, në kushtet e ekonomisë së tregut, kërkohet të gjejë partnerin kryesor në ushtrim të funksioneve,

kompetencave apo detyrave të tij në interes të komunitetit. Këshilli duhet të vërë në plan të parë arsyetimin se biznesi është faktor shumë i rëndësishëm si burimi i vlerave

materiale dhe financiare nepërmjet detyrimeve fiskale, të cilat mund të vihen në shërbim të komunitetit, si në fushën e shërbimeve publike vendore, ashtu edhe për përmirësimin e kushteve materiale të individëve në veçanti si punëmarrës.

* Këshilli, sipas ligjit, duhet të përcaktojë sa më objektivisht për bazën dhe nivelin e detyrimeve që ka biznesi para qeverisjes vendore, të vendos rregulla për trajtimin e barabartë të tyre në raport me detyrimet dhe të kërkojë plotësimin e detyrimeve.

* Ndërkohë këshilli kërkohet të marrë masa për të stimuluar ecurinë sa më normale por të ligjshme të punës nga secili subjekt privat që vepron në territorin e njësisë. Këshilli duhet të ofrojë biznesin dhe të evidentojë faktorët që e ndihmojnë atë të jetë më i pranishëm dhe më efektiv për

zhvillimin e njësisë. Në mënyrë më të veçantë këshilli duhet të përcaktojë me përparësi plotësimin e detyrave në fushën e shërbimeve publike me karakter vendor me qëllim që biznesi të ketë kushte sa më optimale zhvillimi.

* Këshilli duhet të gjejë forma sa më efektive të partneritetit publik- privat. Nepërmjet sektorit privat mund të përballohen mjaft detyra që kanë organet e qeverisjes vendore aktualisht në bazë të ligjit. Me sektorin privat mund të ushtrohen më gjërë por edhe më me efektivitet realizimi i shumë shërbimeve publike. Ai mund të jetë bashkëfinancues i veprimtarive të ndryshme në dobi të komunitetit madje edhe i investimeve publike vendore. Fushat janë të gjëra, kërkohet frymë konstruktive dhe bashkëpunimi.

e. Partneriteti me organizatat jofitimprurëse

Organizatat jofitimprurëse duhen vlerësuar si një partner serioz që kontribuojnë mjaft efektivisht në zhvillimin e komunitetit.

* Këshilli duhet të kërkojë forma që të ndihmohet nga veprimtaria e organizatave jofitimprurëse. Ato duhen përfshirë sa më gjërë si një mundësi më shumë për të rritur shkallën e komunikimit me banorët dhe në veçanti me

grupe të interesit që ato në mënyrë specifike angazhojnë.

* Organizatat jofitimprurëse duhet të mbahen më afër nga këshilli sidomos në kuadër të kryerjes së analizave dhe studimeve në njësinë vendore, të hartimit të programeve të zhvillimit, në sondazhe e testime për reagimin qytetar në lidhje me qeverisjen, si dhe në përpunimin e opinionit etj.

II. Transparenca, komunikimi dhe pjesëmarrja e komunitetit në qeverisje

Përparësia e sistemit demokratik të qeverisjes, e shprehur sidomos në këndvështrimin e qeverisjes vendore qëndon, krahas të tjerave, kryesisht në faktin që pushteti afrohet tek qytetarët, se në qendër të vëmendjes së proceseve zhvilluese vendosen aspiratat dhe përparësitë që kanë qytetarët në tërësi. Procesi i tranzicionit në Shqipëri kërkon nga qeveritë vendore të angazhohen qytetarët në qeverisjen demokratike, gjë që krijon një ambient transparent e të besueshëm.

Pse duhet pjesëmarrja qytetare në vendimarrje?

Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka pësuar ndryshime të mëdha në sistemin ekonomik dhe politik. Shumë shpesh qytetarët nuk i kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe si rrjedhojë nuk janë në gjendje të shprehin opinionet dhe shqetësimet e tyre.

Pjesëmarrja Publike është një element kyç për demokracinë. Pjesëmarrja publike rrit transparencën në procesin e vendim-marrjes. Nëse qytetarët përfshihen në politikën e zhvillimit, ata do të jenë të aftë të nxisin nënpunësit e qeverisë për të

qënë më të përgjegjshëm për vendimet e tyre. Individëd mund të përfshihen në procesin e vendim-marjes, dhe kontributi i tyre mund të ndihmojë në gjetjen e

zgjidhjeve të volitshme të problemeve, si strehimi ose arsimimi i komunitetit, të cilat janë pjesë integrale e jetës së tyre të përditshme

Kush duhet të marrë pjesë?

Individëd dhe grupet që janë të përfshirë në proces ose që influencojnë në procesin e vendim-marjes janë quajtur aktorë (pjesëmarrës). Këta janë persona që kanë interes në politikat e zhvillimit dhe që duan të shprehin opinionin e tyre. Çdo qytetar duhet të marrë pjesë në procesin e vendim-marjes në nivelin lokal, sepse, në një farë mënyre, ai ose ajo do të influencohet nga politikat e zbatuara nga qeveria.

Por qytetaret nuk do marrin dot pjese nese ata nuk i njohin mjetet e format e pjesemarrjes, jane drejtuesit

ata qe kane vullnetin politik per te informuar e komunikuar me komunitetin. Këshilli i bashkisë ose komunës për të qënë në gjendje t'i shërbejë qytetarëve të vet, me qellim që si organi përfaqësues i komunitetit të veprojë në dobi të tij, kërkohet të gjejë mjete, mënyra dhe mundësi për të përfshirë sa më gjërë komunitetin në qeverisje. Duke qënë të njohur me veprimtarinë qeverisëse, duke qënë aktiv dhe sa më të përfshirë, ato janë njëkohësisht më të ndërgjegjësuar në angazhimet e tyre për plorësimin e detyrimeve qytetare.

Cilat mund të jenë disa drejtime të punës për transparencë dhe pjesëmarrje të qytetarëve ?

Duhet përdorur drejtë dy drejtimet e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje: pjesëmarrja pasive që kufizohet në informimin e thjeshtë të komunitetit dhe pjesëmarrje aktive që nënkupton përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe në proces të zbatimit. Komuniteti duhet të jetë i përfshirë sa më gjërë në procesin qeverisës. Ai bëhet i dobishëm kur përfshihet aktivisht në procesin e gjetjes së zgjidhjeve më të mira, por në të njëjten mënyrë ai mund të kontribuojë efektivisht në procesin e realizimit.

Kur duhet të organizohet pjesëmarrja publike?

Pjesëmarrja e qytetarëve nuk duhet kërkuar në situata të veçanta, por duhet të jetë pjesë e jetës së përditshme të qytetarëve. Pjesëmarrja publike nuk është një ngjarje sezonale. është e drejta dhe detyra e çdokujt të marrë pjesë në qeverisje jo vetëm gjatë periudhës së zgjedhjeve por edhe gjatë kohës së qeverisjes midis zgjedhjeve. Shperndarja e informacionit rreth politikave dhe çështjeve në zhvillim mund të bëhet nga poshtë lartë (qytetarët shprehin shqetësimet e tyre) dhe nga lart poshtë (nëpunësit informojnë qytetarët rreth politikave që po zhvillohen dhe mocionin e të drejtave dhe detyrave të tyre).

Cfarë kërkon menaxhimi i mirë i pjesëmarrjes së publikut ?

Organizimi i veprimtarive me pjesëmarrje të publikut, shoqërohet me kosto per financuar mjetet e komunikimit. Kjo kërkon që nga ana e organeve të zgjedhura, të mbahet një qendrim konstruktiv për përballimin e tyre Këshilli duhet të mbajë qëndrim të drejtë ndaj justifikimeve të paargumentuara për pamundësi financiare apo materiale që mund të paraqiten nga zyrtarë të ndryshëm, të mos pajtohet me dembelizmin për të marrë përsipër probleme, me nënvleftësimin e mendimeve, sugjerimeve dhe rezultateve të të tjerëve, përceptimin afatshkurtër që nuk lejon të shihen gjërat në perspektivën e tyre për një zgjidhje të qendrueshme etj.

Faktori tjetër i rëndësishëm është KOHA,

duhet të organizohet marrja e mendimeve në kohën e duhur që do të thotë, përpara se të merret vendimi, e ky proces kërkon dite, javë apo muaj.

Kush janë grupet që marrin pjesë?

Në veprimtaritë me pjesëmarrje të qytetarëve kërkohet gjithë përfshirje. Kjo bëhet me planifikimin e pjesëmarrjes së gjinive të ndryshme, moshave, grupeve të ndryshme të interesit etj. Veprimtaritë mund të bëhen të pjesëshme, me grupe të caktuara pjesëmarrësish ose duke thirur në një takim të gjithë aktorët e mundshëm. fushës ose vetëm me grupe të caktuara të interesit.

Bashkepunimi me Eksperte

Metodat e pjesëmarrjes së qytetareve përfshijnë bashkepunimin me ekspertet profesioniste, si specialiste në

arsimin publik, apo ekspertet e financave publike, mbledhjet e hapura dhe ceshtjet mbi buxhetin

Kush jane pengesat per pjeseamrrjen qytetare?

- ☒ Mungesa e besimit
- ☒ Mungesa e bashkpunimit midis pjesmarresve
- ☒ Informacioni i kufizuar
- ☒ Pak njohuri mbi te drejtat e detyrimet
- ☒ Frike nga e panjohura
- ☒ Mungesa e vetbesimit
- ☒ Mungesa ose kufizimi i strukturave
- ☒ Mungesa e aftesive, kultures se pjesmarrjes dhe eksperiencas ne kete fushe.
- ☒ Mungesa e burimeve (eksperience, kohe, fonde, aftesi)
- ☒ Mungesa e vemendjes se medias per ceshtjet lokale
- ☒ Mungesa e njohurive
- ☒ Risku i deshtimit
- ☒ Fokusi eshte ne nje ceshtje te vogel me shume sesa ne nje ceshtje me te madhe.

Si ti kapercenjme ato?

- ☒ Nepermjet; edukimit publik dhe trainimeve
- ☒ Fushatave ndergjegjesuese publike
- ☒ Strategjive te komunikimit
- ☒ Komunikimit ne rrjet
- ☒ Shkembimit te eksperiencave
- ☒ Pritjes se aftesive menaxhuese

Cilat mënyra duhen përdorur për pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje ?

► MBLEDHJA E HAPUR

Është një takim i kërkuar nga qytetarët ose nga Qeveria Vendore. Mbledhjet e Hapura mund të kërkojnë me ligj si për shembull gjatë procesit të buxhetimit ose mund të organizohen me kërkesë të Këshillit Bashkiak për të paraqitur një çështje dhe për të grumbulluar opinionet e qytetarëve mbi një çështje. Mbledhjet e Hapura organizohen për të prezantuar një çështje apo projekt të propozuar nga Qeveria Vendore dhe vendimet që janë marrë apo mund të merren. Mbledhjet e Hapura gjithashtu mundësojnë grumbullimin e komenteve nga qytetarë ose grupe, të cilat mund të preken nga ky vendim. Takimi zyrtar publik zhvillohet zakonisht

kur është përcaktuar qartë një vendim dhe pritët vetëm të zbatohet.

Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë Vendore, nenet 33 dhe 34 përmbajnë dispozita për zhvillimin mbledhjeve të hapura si pjesë e proceseve të veçantë

Mbledhjet e hapura duhet të jenë të përgatitura paraprakisht sidomos në drejtimet e mëposhtme:

- Duhen marrë masa administrative paraprake për sigurimin e kushteve për zhvillimin normal të saj. Kjo fillon me njoftimin në kohë të publikut për orarin, për problemin që do të trajtohet, organizimin e ambientit ku do të zhvillohet mbledhja etj.

- Paraqitja sa më e kualifikuar në mbledhje e problemit për diskutim, me argumenta, madje sipas gjykimit rast pas rasti edhe me variante të paramenduara për zgjidhje.

- Pjesëmarrësit dhe, në veçanti drejtuesit, të jenë të predispozuar të mirëkuptojnë të tjerët si dhe të kuptojnë çfarë shtrohet dhe propozohet, me synim arritjen e një konsensusi. E rëndësishme është që të vlerësohen mendimet, të

administrohen mendimet që i japin garanci banorëve për dobinë e tyre, me synim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm dhe i besueshëm për degjimin e banorëve.

- Mbi bazën e perfundimeve të arritura në mbledhje të bëhet e mundur që ato të trajtohen e përfshihen në vendimmarrje, në programe pune deri edhe në realizime konkrete.

▶ SONDAZHI I QYTETARËVE

Është një mënyrë për të tërhequr opinionet dhe komentet e qytetarëve mbi shërbimet publike dhe çështjet në fokus të Bashkisë, kur doni të kontaktoni sa më shumë qytetarë dhe të merrni sa më shumë përgjigje.

- Ekzistojnë shumë mënyra për ta arritur këtë. Ka edhe lloje anketimesh, me një pyetje te vetme, në sondazhe të ndërlikuar dhe me vlera

statistikore. Është e rëndësishme të zgjidhni një formë që u përshtatet më mirë nevojave tuaja. Sondazhet me vlera statistikore sigurojnë që rezultatet tuaja të paraqesin shumëllojshmërinë e opinionëve pa keqinterpretuar rëndësinë e një opinionit ndaj tjetrit. Gjë që do të thotë se ata trajtohen në mënyrë të barabartë sipas

vendndodhjes, gjinisë, moshës, etj. Nëse vendosni të zhvilloni një sondazh me vlera statistikore, ju duhet ndihma e një eksperti, kompanie, OJQ-je, etj me përvojë për hartimin e pyetësorit, përcaktimin e listës me vlera statistikore të të anketuarve dhe për interpretimin e rezultateve.

Ju keni në dispozicion metoda më pak të shtrenjta. Alternativa e një pyetësori të thjeshtë që shperndahet nëpërmjet postës është një prej këtyre metodave. Shumë prej hapave mund të realizohen nga personeli i pushtetit vendor me ndihmë minimale nga një ekspert me përvojë në anketime.

▶ GRUPET KËSHILLIMORË TE PERHERSHME TË QYTETARËVE

Krijohen për të punuar gjatë një periudhe relativisht të gjatë kohe. Anëtarët e grupit janë vullnetarë të cilët janë të interesuar në mbarëvajtjen e komunitetit. Çdo grup këshillimor ka një funksion të caktuar dhe bën rekomandime mbi një çështjet pranë Kryetarit të Bashkisë dhe/ose Këshillit Bashkiak. Shembuj të funksioneve për grupet këshillimorë të qytetarëve

janë: shqyrtimi i planeve urbane, ndjekja dhe realizimi I veprimtarive kulturore vjetore dhe planifikimi i investimeve kapitale — çdo gjë që kërkon azhornim, vleresim ose vendime në vazhdimësi. Grupet këshillimorë bëjnë vetem rekomandime. Ata nuk kanë autoritet të pavarur për marrjen e vendimeve. Grupet këshillimorë të qytetarëve kanë një anëtarësim me rotacion dhe emërohen nga

Kryetari i Bashkisë dhe/ose Këshilli Bashkiak. Këta grupe mund të ndihmojnë në lehtësimin e Kryetarit ose Këshillit Bashkiak prej detyrave rutinë që kërkojnë shumë kohë dhe kërkime për të marrë vendimet e duhura. Grupi këshillimorë shqyrton çështjen,

siguron informacion dhe bën rekomandime pranë Kryetarit dhe/ose Këshillit Bashkiak. Ai ndihmon qytetarët të kuptojnë, të kontribuojnë dhe përgjithësisht të bien dakord me vendimet që marrin zyrtarët bashkiakë.



MEDIA

Përbën një nga mjetet më aktiv të komunikimit me publikun. Media është përçues i mesazheve, i shqetësimeve, prezantues i punës që kryhet, i gjendjes dhe masave që merren, i të kaluarës dhe perspektivës etj. Në këtë kuptim media ndihmon si mjet komunikimi i organeve të qeverisjes vendore me publikun në të gjithë dinamikën e jetës. Media përdoret për të komunikuar në paraqitjen e analizave e vendimeve, në pasqyrimin e veprimtarive investuese, të

sherbimeve apo të aktiviteteve të tjera. Ndërkohe media ka mundësuar të bëhen mbledhje të hapura të organeve përfaqesuese, të jepen mesazhe nga mbledhja por edhe me transmetim të drejtpërdrejtë të të gjithë seancës me diskutime, propozime, vendime etj. Tanimë këto praktika po zgjerohen dhe duhet të vazhdohet të zgjerohen dhe pasurohen me tej.

▶ ZYRA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Përbën një njësi të strukturës administrative me anë të cilës këshilli apo administrata e bashkisë ose komunës mban lidhje të qëndrueshme me komunitetin. Zyra është një vend pranë hyrjes së bashkisë, ose komunes e cila siguron informacion dhe/ose shërbime për qytetarët, për t'i ndihmuar ata në zgjidhjen e problemeve komplekse që ato kanë me Qeverinë Vendor. Kjo mund të jetë një zyrë ose një tryezë. Kjo do

të varet nga sa shërbime/informacion ju vendosni të ofroni në këtë zyrë, që mund të shërbeje :

- Për të shpërndarë informacion mbi shërbimet dhe aktivitetet e bashkisë.

- Për të ndihmuar qytetarët në zgjidhjen e problemeve që kanë lidhje me shërbimet e bashkisë.


- Për të përshpejtuar proceset e lejeve

- Për të pranuar, rregjistruar dhe për t'iu përgjigjur ankesave të Qytetarëve

▶ GAZETA BASHKIAKE

është një botim i Qeverisë Vendore që synon të rrisë transparencën duke u treguar qytetarëve funksionet dhe aktivitetet e Komunes apo Bashkisë.. Gazetapërmban artikuj të shkurtër në lidhje

me funksionet dhe veprimtaritë e njesise vendore. Mund të përmbajë gjithashtu ligje të reja dhe një shpjegim të këtyre ligjeve. Aty mund të përfshihen vendimet e Komisioneve për Rregullimin e Territorit,



vendime dhe njoftime të këshillit bashkiak dhe njoftime të takimeve publike dhe veprimtarive të tjera, njoftimet e prokurimeve. Informacioni

mbi buxhetin, mund të botohet gjithashtu me grafikë dhe skica të shkurtra për t'a shpjeguar

III. Puna e këshillit të bashkisë ose komunës për hartimin dhe zbatimin e buxhetit

Buxheti i bashkisë ose komunës përbën një nga dokumentet më të rendësishëm në veprimtarinë e këshillit. Kjo sepse buxheti i njësisë vendore është sinteza e angazhimeve, është materializimi i masës dhe mënyrës së krijimit dhe përdorimit të të ardhurave monetare publike në dobi të

komunitetit. Nga ana e qeverisjes vendore mund të mendohet e pretendohet për shumë gjëra, mund të kemi dëshirë për shumë punë por, vetëm ato që përcaktohen në buxhetin e njësisë mund të bëhen realitet. Në këte kuptim hartimi i buxhetit dhe, padyshim puna për zbatimin e tij, përbëjnë një nga detyrat më madhore për këshillin e bashkisë ose komunës.

a. Si mundësohet angazhimi i këshillit të bashkisë ose komunës në punën me buxhetin?

Me qëllim që buxheti vjetor të jetë program financiar vjetor në shërbim të programit për plotësimin e angazhimeve përspektive dhe afatgjatë të tij para komunitetit, është e nevojshme që këshilli të

marrë parasysh disa kërkesa ndër të cilat përmendim:

* Hartimi dhe zbatimi i buxhetit janë proçes gjithë vjetor dhe gjithë përfshirës. Kjo nënkupton kërkesën që për buxhetin të punohet gjatë gjithë

vitit dhe të përfshihen të gjithë strukturat brenda këshillit, administrata e bashkisë ose komunës me të gjithë segmentet e saj si dhe institucionet në varësi të organeve të qeverisjes vendore dhe, nepërmjet tyre, të përfshihen në proces të gjithë aktorët e mundshëm brenda njësisë. Në këte këndvështrim në çdo periudhë të vitit ka punë për të bërë në funksion të buxhetit. Këshilli në programin e tij vjetor kërkohet të parashikojë veprime në zbatim të detyrave themelore për hartimin e zbatimin e buxhetit dhe angazhimin e të gjithë aktorëve të mundshëm. (tabelë grafike e procesit gjithëvjetor)

* Të njihet sa më mirë dhe konkretisht gjendja për problemet në zhvillimin ekonomik- shoqëror të komunitetit. Këshilli, nepërmjet administratës, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet dhe institucionet e mundshme, të grumbullojë informacione dhe të dhëna të detajuara dhe

metodikidht sa më të dobishme si bazë e domosdoshme për hartimin e programeve sa më të studiuar. Ndërkohë këshilli duhet të njohë sa më mirë situatën në terren, sidomos për fusha të tilla si infrastruktura vendore, niveli i shërbimeve, gjendja e institucioneve publike, kushtet e biznesit, etj të cilat janë objekt i qeverisjes vendore.

* Të bëhen analiza të gjendjes në fusha, kohë të ndryshme dhe në mënyrë sistematike, me synim që të gjenden shkaqet si dhe të përcaktohen rrugët për të zgjidhjet e nevojshme.

* Këshilli i bashkisë ose komunës të hartojë dhe miratojë programe strategjike të zhvillimit ekonomik-shoqëror në tërësi por edhe programe sektoriale. Kjo sepse gjërësia e problemeve publike me karakter vendor kërkon

përcaktimin e drejtimeve në perspektivë. Në këto kushte ka nevojë që krahas parashikimit të zhvillimeve strategjike dhe përmirësimeve në jetën publike në tërësi, të përcaktohen prioritetet që janë të domosdoshme për fusha dhe në kohë të caktuar, si dhe të parashikohen fondet e nevojshme për të garantuar sukses por edhe për një efektivitet më të lartë për komunitetin.

* Mbi bazën e programeve strategjike

këshilli duhet të angazhohet në përgatitjen nga strukturat e specializuara të studimeve dhe projekteve konkrete të shoqëruar edhe me faturën financiare të domosdoshme për plotësimin e tyre.

* Këshilli duhet të njohë hapsirat ligjore, të njohë mirë rolin që mund të luaj ai vetë në zhvillim si dhe të vlerësojë dhe përdorë të gjitha mundësitë për bashkëpunim me struktura të tjera qeverisëse por edhe të aftësohet për të përdorur në mënyrë sa më efektive format e partneritetit me sektorin privat, të ofrojë donatorë etj.

b. Si mundet që këshilltarët të përfshihen në hartimin dhe zbatimin e buxhetit ?

* Këshilltari individualisht lipset të njohë mirë gjendjen në komunitet. Kjo do ti duhet atij për një kontribut aktiv në planifikimin e treguesve të buxhetit, si për të ardhurat ashtu edhe shpenzimet, ashtu

edhe në procesin e zbatimit.

* Këshilltari duhet të mbajë kontakte të vazhdueshme me banorët dhe aktorët e interesit. Në mënyrë të veçantë kjo duhet përdorur drejtë, nga njera anë për të njohur më nga afër

kërkesat e tyre por nga ana tjetër, për të parë dhe vlerësuar mundësitë e tyre zhvilluese dhe kontribuese.

* Këshilltari duhet të marrë pjesë aktive në veprimtarinë që organizon këshilli apo administrata e bashkisë ose komunës për probleme të planifikimit në fusha me karakter zhvillues ekonomiko-social dhe të lidhura këto me përdorimin e mjeteve financiare.

* Këshilltari në veçanti dhe i gjithë këshilli duhet të kërkojnë që paraqitja në komisione dhe në këshill e projektbuxhetit dhe raportimeve përkatëse të jenë sa më të qarta për te, pavarësisht nga teknikat financiare. Ai kurrë nuk duhet të lejojë që të pranojë zgjidhje në buxhet pa u ndërgjegjësuar për ato që propozohet por duke bërë vlerësime për më të dobishmen dhe të shprehet lirisht në

mbledhjen e këshillit dhe në komisionin përkatës për rezervat që mund të ketë.

* Këshilltari, në vlerësimin e situatës nga ana e tij, krahas përpjekjeve për të mbajtur parasysh premtimet dhe programet elektorale, duhet të verë në qendër të vemendjes kërkesat dhe interesat aktuale të komunitetit. Trajtimi i njëanëshëm, thjesht në interesa partiake apo trajtimi i diferencuar i shtresave, grupeve të ndryshme apo individëve të veçantë në fushën e planifikimit dhe përdorimit të fondeve publike, përbën një formë të keqpërdorimit me detyrën, madje përbën element të korrupsionit. Këte duhet ta kërkojë këshilltari tek ekzekutivi por njëkohësisht duhet të jetë vetë i çliruar nga këto fenomene.


c. Si mund të veprojnë komisionet e këshillit për hartimin dhe zbatimin e buxhetit ?

* Detyra të veçanta në punën për hartimin dhe zbatimin e buxhetit ka komisioni i financave dhe buxhetit pranë këshillit të bashkisë ose komunës. Ky komision kërkohet të jetë i mirë organizuar dhe sa më i përgatitur të analizojë dhe të bëjë oponencën për të gjithë projektbuxhetin në fazën e hartimit por edhe gjatë zbatimit. Në mënyrë sa më të argumentuar ky komision duhet të kontribuojë që buxheti vjetor dhe ai trevjeçar afatmesëm të ndertohet duke reflektuar vendimet e këshillit por edhe kërkesat ligjore në fushën e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

* Në punën me buxhetin, si në planifikimin ashtu edhe të zbatimit kërkohet angazhimi i të gjithë komisioneve të këshillit. Janë mundësitë që me këte

qellim këshilli të ngrej edhe komisione të posaçme. Çdo komision mbulon një fushë të caktuar dhe domosdoshmërisht ajo përbën pjesë të buxhetit. Komisioni përkatës njeh më nga afër problemet dhe nevojat dhe si i tillë duhet të kontribuojë efektivisht në përcaktimin e fondeve të nevojshme. Aq më tepër kjo bëhet mëse e nevojshme për shkak të mosplotësimit të nevojave gjë që kërkon një përzgjedhje më të drejtë. Konsidratat që ka [do komision mblidhen nga komisioni i buxhetit dhe financave të këshillit I cili bën rakordimin përfundimtarë në projektbuxhetin që do t'i paraqitet këshillit.

* Në komisione secili këshilltarë duhet të jetë aktiv me kontributin e tij. Kjo nuk do të thotë thjeshtë pjesëmarrje por përfshirje në debat, obligimi për të prezantuar me argumente sa



më bindëse kërkesat dhe opinionet e banorëve.

* Komisioni duhet të kërkojë nga administrata seriozitetin e duhur për t'i prezantuar sa më

mirë gjendjen dhe propozimet e argumentuara, aspektet pozitive dhe negative të sejcilit nga zërat e buxhetit si dhe mendimet e akumuluarra gjatë vitit.

IV. Çeshtje te Etikes për këshilltarët e Keshillave Vendore:

Çfare eshte kodi i etikes?

Kodi i etikes eshte nje teresi rregullash qe percaktojne standartet e sjelljes se punonjesve te administrates vendore dhe te zgjedhurve. Keto standarte i ndihmojne punonjesit te dallojne sjellje te pranueshme nga ato qe ne fakt jane te papranueshme,

ne rast se zbatohen, si edhe te ruajne dhe nxisin besimin e qytetareve ndaj institucionit. Kodi i etikes per pushtetin vendor siguron nje baze ligjore apo morale, mbi baze te ciles administrata lokale dhe keshilltarët do te veprojne gjate ushtrimit te funksioneve te tyre.

Perse duhet te zbatohet kodi i etikes nga qeverisja vendore?

Marreveshja me qeverine vendore eshte, per shume njerez, kontakti me domethenes me sektorin publik. Cdo person merr nga qeveria vendore sherbime publike, te domosdoshme,

jetike, qe ndikojne ne cilesine e jetes se qytetareve. Prandaj, eshte e rendesishme qe qeveria vendore te veproje me eficence dhe efektivitet dhe te jete sa me shume rezistente ndaj korrupsionit.

Cilat jane perfitimet qe vijne nga zbatimi efektiv i rregullave te etikes nga punonjesit e administrates se bashkise dhe keshilltareve bashkiake?

Qe nje kod etik te jete efektiv ai kerkon :

* Ekzistencen e rregullave te qarta qe rregullojne vleresimin e veprimeve dhe sjelljeve te punonjesve te bashkise apo keshilltareve te zgjedhur lokale. Kodi te jete inkurajues dhe me cilesi, te pakten ne disa pjese dhe jo te jete vetem nje permbledhje e te gjithveprimeve te ndaluara. Kjo, per ti dhene nje karakter pozitiv me shume se sa nje pamje te ashpër te nje kodi penal.

* Qe rregullat e percaktuara ne kod te behen publike dhe qytetaret te njihen me to. Per te qene efektive, organizatat (bashkite) duhet t'i publikojne dhe pjestaret e tyre te njihen me to ne menyre qe te gjithve te jene ne dijeni per ekzistencen e tyre;

* Qe rregullat te mos zbatohen ne menyre retroaktive;

* Qe rregullat te jene te kuptueshme;

* Qe rregullat te mos jene kontradiktore;

* Qe zbatimi i rregullave te jete i detyrueshem per punonjesit dhe te zgjedhurit lokale, por nderkohe keto rregulla t'i kuptojne dhe tu binden edhe qytetaret;

* Qe keto rregulla te jene sa me te qendrueshme ne kohe dhe ne perputhje me tendencat dhe kerkesat e zhvillimit te procesit te decentranizimit.

Zbatimi i kodit te etikes

nga punonjesit e bashkise ndihmon ne :

- Ulja e numrit te veprimeve abuzive nga punonjesit;

- Permirosimi i komunikimit te brendshem;

- Rritja e kenaqesise per punen;

- Rritja e besimit tek drejtuesit kryesore;

- Rritja e eficences dhe me pak shkelje te ligjeve dhe rregullave;

Per keshilltaret bashkiake:

- Permiroson komunikimin ndermjet tyre dhe qytetaret;

- Ndhmon ne rritjen e besimit te qytetareve ndaj te zgjedhurve te tyre;

- I ben ata te afte te jene te nderuar dhe te respektuar nga te zgjedhesit e zonave te tyre elektorale;

- I ben te jene te hapur dhe i lejon ata te mbrojne jeten e tyre private;

- Lejon pranimin e rregullave te sjelljes nga te zgjedhurit dhe zgjedhesit e tyre;

Qe nje kod etike te jete efektiv eshte gjithashtu e rendesishme eshte qe te kete nje debat e komunikim te vazhdueshem brenda institucionit (bashkise) keshtu qe punonjesit e administrates te mblidhen here pas here per te folur rreth dilemave qe vijne nga puna e perditshme.

I rendesishem eshte gjithashtu dhe interpretimi i kodit. Ai duhet te mbroje te jete nje mekanizem i detyrueshem, udhezues por edhe mbrojtës për stafin qe punon ne baze te parimeve dhe rregullave tij. Per kete arsye, nje kod efektiv kryesisht do te kete te percaktuar nje burim udhezimesh dhe keshillash per stafin.

Cfare eshte Infrastruktura Etike

Nje “infrastruktura etike” perfshin mjetet, sistemet dhe kushtet qe nxisin profesionalizem dhe standarte te larta etike (sjelljeje). Si ne nivel qendror ashtu edhe ne ate vendor venia ne jete e tyre kerkon realizimin dy elementeve kyc:

* Angazhimi politik: Pa pasur nje mbeshtetje te vertete politike – mesazhe te qarta nga drejtuesit e qeverise vendore se sjelljet joetike nuk do te tolerohen – nxitjet per permiresimin e etikave ne administraten bashkiake nuk do te jene te vlefshme.

* Baza ligjore efektive: Baza ligjore efektive perbehet nga nje kuader ligjesh dhe rregullash qe percaktojne standartet e sjelljes se punonjesve te administrates publike dhe te zgjedhurve, ne cdo nivel qofshin keta, dhe i

detyrojne ata t’i zbatojne nepermjet nje sistemi investigimi dhe kontrolli. Ne kontrollin e bazes ligjore per menaxhimin e etikes, perfshihen ligji penal dhe ligji civil, aktet ligjore mbi konfliktin te interesave dhe rregullore te ndryshme per punonjesit e administrates publike dhe te zgjedhurit nga populli.

Ndihma kryesore e bazes ligjore per infrastrukturen e etikes eshte vendosja e kufizimeve ne sjelljen e punonjesve te administrates vendore, duke iu imponuar atyre me sanksione duke permiresuar transparencen e veprimeve te qeverisjes vendore. Standardet e sjelljes te pritura nga punonjesit e administrates bashkiake jane detyrimisht te larta, bazuar ne faktin qe ata administrojne fuqine dhe

burimet e shtetit ne nivelin lokal. Ligji qe ka te beje me integritetin, vendos detyrime ligjore per standartet e pritura dhe percakton pasojat ne rast se ato nuk arrihen.

* Mekanizmat monitories dhe kontrollues : Mekanizmat monitorues vendosin rregulla per veprimtarine e qeverise vendore, apo keshillave lokale, te cilat sherbejne per te kontrolluar nese rezultatet jane arritur, dhe vete procesi ka qene ne observim. Ato perfshijne procedura te brendshme administrative, procese te plota sic jane vleresimet dhe kontrollet e veprimtarise se nje strukture te caktuar. Pjesemarrja e shoqerise civile dhe qytetareve ne proceset monitoruese konsiderohet si nje nga mekanizmat me efektive monitorues.

* Mekanizma te ngritjes profesionale: Keto jane proceset ku punonjesit e

administrates bashkiake mesojne dhe imponojne etiken, standartet e sjelljes dhe vlerat e sherbimit publik. Trainimi eshte nje element shume i rendesishem bashke me modelet e mira te pergjegjesise se punonjesve per pozicionin dhe detyrat qe ata ushtrojne.

* Kushte te pershtatshme dhe nxitese te sherbimit publik: Neqoftese punonjesit e administrates punojne me shume se c' duhet dhe ndihen te pasigurte, atehere ata do te jene me pak te gatshem te respektojne rregullat e etikes dhe nxisin iniciativat per permiresim ne fushen e etikes. Shpesh veprime joetike te punonjesve justifikohen me nivelin jo te kenaqshem te pagave. Pagesa e ulet nuk eshte justifikim per sjelljet jashte rregullave dhe etikes.

* Standartet e etikes: Cdo kod etike formulohet brenda standarteve te caktuara te etikes, te cilat duhet te jene te

qendrueshme dhe dinamike. Ato duhet te jene te percaktuara qarte, por njekohesisht te rishikohen here pas here, ne menyre qe t' u pershtaten standarteve dhe tendencave te zhvillimit te shoqerise ne periudha kohe te caktuara.

Shembull: Komunikimi ne Sallen e Mbledhjeve :

a. Keshilltaret Bashkiake duhet te zene vendet e tyre ne Sallen e Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak perpara kohes se percaktuar per fillimin e mbledhjes.

b. Keshilltaret nuk duhet t' u nderpresin fjalen folesve te tjere , te marrin fjalen perpara se t' u jepet nga Kryetari, te bejne verejtje personale, te perdorin fjale ofenduese apo kercenime, zbulojne informacione qe lidhen me jeten private ose qe mund te kompromentojne reputacionin e qytetareve, te sillen ne menyre te pahijshme, prishin qetesine dhe procedimin normal te mbledhjeve ne Sallen e Keshillit Bashkiak

c. Kryetari i Keshilit duhet te disiplinoje Keshilltaret e padisiplinuar, nepermjet marrjes se masave te meposhteme :

- * Te kerkojne vendosjen e rregullit
- * Ti terheqe vemendjen
- * Te urdherojne nderprerjen e fjales se tyre

* Te urdheroje largimin nga Salla e Mbledhjeve

e. Cdo folesi, i cili nisët nga pyetjet e debatueshme ose nderpret mbajtjen e rregullt të mbledhjeve, do t'i kerkohet që të zbatohet rregullin.

f. Cdo folesi që do të atakohet në Mbledhjen e Keshillit ndonjë anëtar tjetër të Keshillit, duke përdorur gjuhë ofenduese, do t'i terhiqet verejtje.

g. Kryetari do të urdherohet folesin të nderprese fjalën e tij/saj kur folesi në fjale vazhdon të flase, duke tejkaluar pa leje, kohën e tij/saj të lejuar dhe pasi ky është paralajmëruar do t'i nderprese fjalën, nëse folesi vazhdon të thyejë rregullin.

gj. Kryetari mund të pezullojë një Këshilltar nga marrja pjesë në mbledhje deri në votimin e ardhshëm në rast të Këshilltari :

* Përdor fjalë të rënda, si reagim ndaj denimeve të dhëna ndaj tij/saj, si rezultat sjelljeve të tij të parregullta dhe thyerjes së disiplinës së mbledhjeve.

* Ben thirrje për dhunë

*Ofendon ndonjë Këshilltar tjetër ose Këshillin Bashkiak .

h. Cdo masë e tillë disiplinore do të regjistrohet në protokollin përkatës të mbledhjes.

i. Asnje Këshilltar Bashkiak nuk do ti lejohet që, me dije dhe dëshirë të plotë, të nxisë apo shtrengoje ndonjë person tjetër të shkele këtë Kod Etike.

Procedurat që ndjek këshilli për hartimin dhe zbatimin e buxhetit

Cfare është Buxheti Vendor?

Buxheti vendor – është baza ligjore për mbledhjen e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve për zbatimin e strategjive dhe politikave vendore të përcaktuara nga këshilli vendor.

Kush merr pjesë në këtë proces?

Detyra për organizimin e procesit të përgatitjes së projekt buxhetit, me ligj i është caktuar kryetarit të B/K dhe stafit perkates.

Sipas Ligjit Organik 8652, Neni 32 , Këshilli i Bashkisë dhe Komunës miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij, gjithashtu:

- Vendos për taksat e tarifave vendore, si dhe nivelin e tyre.
- Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Secili institucion ka detyra te parashikuara me ligjin organik,si dhe ne statutin dhe rregulloren e B/K.

Rolet dhe Përgjegjësitë e aktoreve kryesore ne procesin e buxhetit

- Këshilli Vendor:** Përcakton kalendarin e buxhetit, vendos prioritetet dhe nivelet e shërbimeve
- Kryetari i Bashkisë:** Nxjerr udhëzimet e buxhetit dhe përgatit projekt buxhetin brenda kuadrit të prioriteteve dhe niveleve të shërbimeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.
- Departamenti i Financës:** Shpërndan udhëzimet e buxhetit / Koordinon procesin e përgatitjes së projekt buxhetit
- Departamenti i Shërbimeve :** Përgatit dhe paraqet kërkesat e buxhetit pranë Departamentit të Financës

Me interes eshte perfshirja ne procesin e hartimit te projekt Buxhetit dhe te aktoreve te shoqerise civile te cilet sjellin kendveshtrime te reja mbi nevojat dhe prioritetet ,por njekohesisht edhe ekspertizen e pavarur ne procesin e hartimit te buxhetit.

Aktoret e shoqerise civile mund te jene :

Universiteti, Bankat, Dhoma Tregtise, Agjensite Rajonale te Zhvillimit,Keshilli i Qarkut ,OJF te Ambientit, kultures,sportit etj.,Shoqata te tjera profesionale, etj.
Ekspert te pavarur ,Organizata Rinore dhe grupeve te tjera me baze gjinie,etj.

Ne cilat faza kalon
përgatitja e Buxhetit?

Sipas ligjit 8379 „Neni 2 :
Buxheti i pushtetit Lokal është
programi kryesor financiar
vjetor i pushtetit lokal në të
cilin përfshihen të gjitha të
ardhurat dhe shpenzimet të
përcaktuara me ligj për kryerjen
e funksioneve që kanë organet
e pushtetit lokal në territorin ku
ato veprojnë. Buxheti lokal
përbëhet nga pjesa e buxhetit të
pavarur dhe pjesa që financohet
nga buxheti i shtetit

Neni 3 : Viti buxhetor është
i njëjti me vitin kalendarik. Viti
buxhetor fillon në 1 janar dhe
mbaron në 31 dhjetor të çdo viti
kalendarik. Hapat në përgatitjen
e një buxheti konsistojnë në:

Hapi 1. Organizimi i
Procesit për draftin e ri të
buxhetit (zakonisht fillon në
muajin prill-maj) Përmban :

- Kalendarin e Buxhetit
përgatitet dhe shpërndahet
- *Kryetari & Këshilli*
përcaktojnë prioritetet &
nivelet e shërbimit
- *Kryetari* dërgon udhëzime

stafit teknik

- *Drejtori i Financës*
shpërndan udhëzimet

Hapi 2 :Parashikimi i të
Ardhurave

- Transferta e
pakushtëzuar
- Të Ardhurat nga Burimet
e Veta
- Të Ardhurat të
Kushtëzuara
- Burime Investimesh

Hapi 3 :Përgatitja e
Kërkesave

- Shefat e Sektorëve*
- Identifikojnë kostot së
plotë për çdo shërbim
- Rekomandojnë
rregullime në nivelet e
shërbimeve
- Përgatisin dokumentin e
buxhetit të sektorit

Hapi 4 :Lidhja e Buxhetit
Drejtori i Financës

- Shqyrton kërkesat e
departamenteve
- Koordinon takime
shqyrtimi me shefat e
sektorëve

- Përgatit Dokumentin e Shqyrtimine Buxhetit për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillim Bashkiak

Hapi 5 :Paraqitja e Projekt Buxhetit tek Kryetari I Bashkisë dhe Këshilli për Shqyrtim

Hapi 6 : Kërkimi tjetër i Mendimit Qytetar

- Konsultime publike për projekt buxhetin

Hapi 7 : Bërja e ndryshimeve

sipas kërkesës së Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit

Hapi 8 : Kërkim tjetër i Mendimit Qytetar pas ndryshimeve


Konsultime publike për projekt buxhetin

Hapi 9 : Aprovimi i Buxhetit nga Këshilli

Hapi 10 : Publikimi i Buxhetit

Hapi 11 : Ekzekutimi i Buxhetit

Hapi 12 : Monitorimi dhe Vleresimi



Ne kete tabelen e mesiperme mund te shikojme ne menyre grafike shperndarjen ne nje vit te te gjithe procesit te pergatitjes se buxhetit i cili eshte nje proces gjithëvjeter.

pika te meposhtme ku ndjehet dhe roli i Keshillit ne bashkepunim me Administraten ne pergatitjen e politikave te zhvillimit. Nder keto permendim:

Cilat jane ceshtjet kryesore qe diskutohen?

Gjate procesit te pergatitjes se buxhetit diskutimet apo konsultimet bazohen ne disa

1. Orientimet politike kane te bejne me perqasjen e materialit te draft buxhetit me programet dhe planin strategjik dhe me ate qe

kryetari mendon dhe është i qarte se çfare presin qytetaret.

Politika përcaktohen per :

1. Shërbimet, që duhet të ofrojë administrata , nivelin dhe shtrirjen e tyre.

2. Krijimin e të ardhurave vendore nëpërmjet mbledhjes së taksave dhe tarifave.

3. Kryerjen e shpenzimeve vendore.

4. Zhvillim ekonomik, social, fizik, arsimor, kulturor dhe rekreativ.

5. Përfshirje të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes për çështje vendore.

2. Te dhenat teknike janë të gjitha informacionet sasiore mbi shërbimet teknike si: te dhena mbi rruget, trotualet, ndricimin etj... mbi shkollat, nr nxenesve per m2 per shkollat, te dhenat per terrenet sportive etj.

3. Kërkimi i Mendimit Qytetar për Prioritetet cdo vit –i domosdoshem mbasi

sigurohet informacion që është përfaqësues në mënyrë statistikore per gjithë zonat dhe mund të sigurojë informacion edhe nga familjet që nuk i përdorin shërbimet. Sigurohet gjithashtu informacion i vlefshëm mbi prioritetet e qytetarëve lidhur me kryerjen faktike te shërbimeve publike

4. Përcaktimi i niveleve te pershtatshme te shërbimeve

Kjo për një shërbim specifik, do te thotë gjetja e ekuilibrit të duhur ndërmjet sasisë, cilësisë dhe kostove të shërbimit përkatës duke mbledhur e diskutuar informacionin e mëposhtëm :

* Çfarë po ecën mirë në lidhje me kryerjen e këtij shërbimi

* Çfarë nuk po ecën mirë

* Çfarë mendojnë qytetarët për performancën e shërbimit

* Cilat janë trendet e jashtme ekzistuese që mund të prekin mënyrën se si kryhet një shërbim

* Çfarë burimesh janë të disponueshme, sa kushton

kryerja e shërbimit

PRA :

Kater informacionet e mesiperme sherbejne si baze e mire qe Keshilli te orientoje prioritetet kryesore dhe nivelet e sherbimeve per vitin e ardhshem.

Disa mënyra të ndryshme për të parë buxhetin :

Dokument politike Përcakton qëllimet dhe objektivat dhe bën një artikulum të prioriteteve të bashkisë

Plan financiar

Përcakton mjetet për realizimin e çdo produkti dhe rezultati

Udhëzues veprimi

Përcakton radhën e zbatimit si, kur dhe përse ndërmerret çdo veprim.

Plan kapital Përcakton përmirësimet kryesore të infrastrukturës dhe ndikimin e tyre në ekonomi, duke përfshirë vendimet lidhur me kombinacionet.

Mjet monitorimi Një pikë qendrore për monitorimin e të

gjitha aktiviteteve dhe efijencën e tyre.

Mjet komunikimi Siguron transparencë dhe përgjegjshmëri

Buxheti i suksesshëm është ai buxhet që është reagues, transparent dhe i përgjegjshëm.

Çfare permban nje buxhet komune apo bashkie?

Buxheti Perbehet nga:

A. TE ARDHURAT

Sipas Nenit 6 te ligjit 8379,date 29.07.1998 “Per hartimin dhe zbatimin e buxhetit te shtetit te Republikes se Shqipërisë”, te ardhurat dhe burimet e tjera financiare te pushtetit lokal perbehen nga :

1. Taksat
2. Tarifat
3. Te ardhura te tjera vendore (jo tatimore)
4. Taksat e perbashketa
5. Transfertat e kushtëzuara
6. Transferta te Pakushtëzuara

7. Donacionet

8. Hua (Kredite) dhe;

9. Te trashëguara nga viti i kaluar

B. SHPENZIMET

Shpenzimet e qeverisjes vendore mbulojnë kostot e operimit dhe funksionimit të njesive të qeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve që janë nën përgjegjësi të qeverisjes vendore.

Sipas ligjit 8379, në shpenzimet e buxhetit lokal përfshihen :

1. Shpenzimet korrente - pagesat për kompensim shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera, transfertat dhe pagesat e interesave

2. Shpenzimet kapitale - ndërtime, rikonstruksionet, blerjet e pasurive kapitale etj

3. Shpenzimet e tjera - për përmbushjen e kompetencave të percaktuara me ligj

a. huadhenia dhe pjesëmarrja në kapitale

b. pagesa e principalit për huamarrje

V. Sistemi I taksave lokale dhe Roli i Keshillit

Çfare janë taksat lokale?

- Taksa që e kanë bazën dhe kufijte minimale të percaktuara me ligj.

Taksa që ligji percakton vetëm llojin e taksës dhe i jep keshillit vendor të drejtën për percaktimin e bazës dhe nivelit.

Keshilli i Bashkisë duke respektuar ligjin ka këtë kompetencë :

? Zbaton ose jo një taksë

? Ben nën kategorizime të tjera të bazës

? Saktëson bazën e taksës për çdo kategori (shumën e sipërfaqeve të ndertesave, sipërfaqeve të hapësirave ku tregtohet etj)

? Percakton nivelin e ri për n/kategoritë brenda kufijve të percaktuara me ligj

? Rrit ose zvogëlon nivelin tregues të taksës me +/- 30 %

? Percakton taksapaguesit (familje, biznes, institucione etj)

? Percakton mënyrën e mbledhjes dhe administrimit të

tyre

Cfare jane tarifat lokale?

Keshilli B/K sipas nenit 16,pika 4 e ligjit 8652 ka kompetence të plote për vendosjen e llojeve , të niveleve dhe rregullave baze per administrimin dhe mbledhjen e *tarifave vendore*.

Sipas ligjit tarifat vendore vendosen :

- per sherbimet publike dhe te infrastruktures te ofruara nga njesia vendore(pastrim,ndricim etj.)

- per leshimin e lejave,licensave,autorizimeve dhe leshimit te dokumentave zyrtare

- per perdorimin e pronave publike vendore (parkim.reklama etj)

Per vendosjen e nje tarife eshte e domosdoshme te percaktohet kostoja e plote e sherbimit.

Askush nuk eshte i prirur te paguaje taksa/tarifa,por

nese politika tatimore eshte e drejte dhe qytetaret e shikojne se taksat e tyre perdoren per te permiresuar komunitetin e tyre,ata jane me te gatshem te paguaje.

Kur vendos kur Keshilli te miratoje politika ? :

1 . Nevoja per me shume fonde

Ka disa faktore te cilet shkaktojne rritje ose renie te shpenzimeve.

* Rritja e sasise dhe/ose cilesise se sherbimeve aktuale lidhet me

- Zgjerim/pakesim te numrit te atyre qe u kryhen sherbimet

- Zone e re qe perfiton per here te pare sherbimin

- Ndryshim ne pagesat/ shperblimet sipas paketes ligjore

- Shkalla e inflacionit
- Permiresim te cilesise se sherbimit ne nje zone (psh.rritje te frekuences se largimit mbeturinave)

- Standarte të reja shërbimi të BE

* Ofrim i shërbimeve të reja

- Kosto të reja për ngritjen e zyres taksave me një ndalesë etj

E rëndësishme është të shqyrtohen këta e të tjerë faktorë për një parashikim dhe argumentim të mirë tek taksapaguesit të nivelit të ardhshëm të shpenzimeve

2. Trendet demografike dhe ekonomike

* Ndryshimi i popullsisë (+/-). Cilat janë implikimet

Kur shtohet një lagje e re duhet të sigurojmë dhe minimumin e shërbimeve të mundshme ndaj familjeve që janë dhe taksapagues. Pra ndikimi i këtij faktori është :

* Mbi shpenzimet, mbi potencialin e të ardhurave

* Efekti i inflacionit, rritmeve ekonomike në bazën dhe nivelin e taksës ose kostot e shërbimeve. Është një faktor që është nga të parët që

merret në konsideratë, mbasi rrit shpenzimet dhe si rrjedhim kërkon politika të kujdeshme të taksave

* Faktore të tjera që ndikojnë në potencialin e të ardhurave apo në kostot e shërbimeve. Ulja e aftësisë paguese, si rezultat i rënies të të ardhurave mesatare për familje, kërkon rishikim të politikave etj.

3. Incentivat kundërshtues ndeshkimit

* Paraja a shpenzuar mirë është nxitesi më i mirë

Qytetarët kur shohin se me të njëjtat para si vitin e kaluar, këto vit u bënë me shumë rrugë pranojnë politika në rritje të taksave, rritet numri atyre që paguajnë

* Transparencë, konsultim, pjesëmarrje

Kur dinë koston e shërbimit që përfitojnë, mënyrën e marrjes së vendimit, kur janë pjesë e procesit të zgjedhjes së buxhetit, kur pyeten “a pranojnë të paguajnë më shumë për një shërbim më të mirë”, do të

pranojne te kontribojne kundrejt politikave te reja

* Zbatim i drejte dhe i ndershem.

Kur shohin qe te gjitha ne kushte te njejta paguajne te njejten takse, kur vendimet e perjashtimeve jane te argumentuara, kur lista e detyrimeve shperndahet per te gjitha, do te ndihmojne ne pagimin e detyrimeve dhe ne politikberje

4. Mundesia (1) A kane mundesi te paguajne te gjitha njesoj.

Eshte shume e domosdoshme te njohim nga afer mundesite e pageses te cdo kategorie

* Kush jane taksapaguesit? Nderto profilin e segmenteve tipike : Pensionistet, profili i nje familje me nje/dy te papune, i nje familjeje me ndihme ekonomike, familjeje me paga buxhetore

* Sa jane te ardhurat e tyre? Sa jane shpenzimet e tyre? Cilat jane detyrimet e tjera te tyre

(taksa, tarifa vendore dhe kombetare)?

* Llogarit efektin e pritshem te nje politike te re te takses mbi taksapaguesit

* A mund te paguajne ata? Cfare perjashtimesh/ lehtesirash nevojiten?

* Rishiko politiken